



Politika për Shëndetin, Sigurimin, Sigurinë dhe Mjedisin (SHSSM)

Objektivi i TAP-it është që në vitin 2020 të sjellë në mënyrë të sigurt dhe me kosto efektive gazin Kaspik në Evropë. Duke qenë i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë dhe detyrat ndaj aksionarëve dhe palëve kryesore të interesit, TAP-i është zotuar të ndjekë standardet e pranuar në nivel ndërkombëtar për shëndetin, sigurimin, sigurinë dhe mjedisin si dhe të përdorë praktikën më të mirë. Ne do të veprimë me etikë dhe me përgjegjësi shoqërore.¹ Ambicia jonë është të shmangim ndikimet negative, të rrisim efektet pozitive dhe të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo politikë zbatohet për të gjitha aktivitetet e TAP-it, nga projektimi dhe ideimi e deri te veprimtaria; parimet e saj vlejnë për të gjithë personelin që punon për TAP-in, si për punonjësit, ashtu dhe për kontraktorët ose furnitorët.

Jemi zotuar të:

- Integrojmë SHSSM-në në mënyrën tonë të punës dhe të tregojmë rëndësinë e SHSSM-së përmes lidershit dhe sjelljes me përfshirje.
- Përqëndrohemi vazhdimisht në përmirësimin e performancës së SHSSM-së, përmes një procesi ku përcaktojmë dhe shqyrtojmë objektiva dhe pikësnyime
- Garantojmë veprimtari të sigurt që mbrojnë njerëzit, mjedisin, komunitetet dhe asetet nwpwmjet implementimit të sistemeve menaxhuese të SHSSM-ve.
- Përfundojmë me ligjet dhe rregulloret kombëtare dhe ne gjithashtu respektojmë ligjet, rregulloret dhe konventat përkatëse ndërkombëtare që kanë të bëjnë me SHSSM.

Si punojmë:

SHSSM-ja Është një Përgjegjësi e Përbashkët

- I gjithë personeli që vepron në emër të TAP-it mban përgjegjësi të sigurojë që politika dhe parimet e SHSSM-së kuptohen dhe zbatohen në të gjitha nivelet e organizatës. Menaxherët do të mbajnë përgjegjësi për performancën e SHSSM-së.

Menaxhimi i Rreziqeve në Kuadër të SHSSM-së

- Ne punojmë sistematikisht që të kuptojmë dhe të administrojmë rrezikun dhe ndërmarrim procese përmirësimi bazuar në anketimet mbi dhe vlerësimin e rrezikut. Rreziqet e SHSSM-së dhe ndikimet dotë evidentohen dhe rreziqet e lidhura me to do të ulen në Nivelin Praktik më të Ulët të Arsyeshëm (parimi ALARP).

Siguria në plan të parë

- Siguria vjen gjithmonë në plan të parë. Ambientet dhe veprimtaria dotë zhvillohen, planifikohen dhe mirëmbahen në mënyrë të tillë që të krijohen pengesa të fuqishme për të parandaluar aksidentet. Të gjithë punonjësit kanë për detyrë të ndërpresin çfarëdolloj pune nëse nuk ka sisteme të përshtatshme për të kontrolluar rreziqet.

¹ Zotimet e TAP-it për angazhimin e paleve kryesore të interesit, çështjet shoqërore dhe mjedisore etj., janë përvijuar në Politiken e TAP-it për Përgjegjësinë Shoqërore të Korporatës dhe zbatohen përmes Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social



Standardet Mjedisore Teknike

- Do të projektohen, ndërtohen dhe vihen në punë ambiente për uljen e konsumit të energjisë, shkarkimeve në ajër, derdhjeve të mbetjeve të lëngshme dhe krijimit të mbetjeve. Do të përdoret parimi i Teknikave më të Mira të Disponueshme (BAT).
- Ne punojmë sistematikisht për të zvogeluar gjurmën fizike të projektit. Ambientet dotë vendosen dhe dotë punojnë për të ulur ndikimet fizike dhe ekologjike.
- Ne mbrojmë dhe ndihmojmë specia tw florws dhe faunws tw cilat ndikohen nga aktivitetet.

Qëndrimi ndaj Personelit

- Shëndeti dhe mirëqenia e personelit janë të rëndësishme për TAP AG. Ne monitorojmë rreziqet nga profesioni që has personeli dhe ndërmarrim veprimet e duhura. Ne synojmë të kemi një mjedis të sigurt dhe tërheqës pune që karakterizohet nga respekti, besimi dhe bashkëpunimi.
- I gjithë personeli do të ketë kualifikimet dhe do të marrë trajnimet e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre.

Kontraktorët dhe Furnitorët

- Menaxhimi i SHSSM-së i kontraktorëve dhe furnitorëve vepron në përputhje me këtë politikë. Për më tepër, ne presim që kontraktorët dhe furnitorët tanë të jenë në përputhje të plotë me këtë Politikë SHSSM.

Përmirësimi i Performancës së SHSSM-së- hetimi i incidenteve, auditi dhe inspektimet

- Ne duam të mësojmë nga gabimet dhe të sigurohemi që ato të mos përsëriten më. Të gjithë individët, qofshin këta kontraktorë apo staf i TAP-it, raportojnë për këtë arsye të gjithë incidentet dhe të gjitha rastet e pothuajse incidenteve. Incidentet dotë hetohen për të evidentuar veprimet që duhet të ndërmerren për të shmangur përsëritjen e tyre. Dotë kryhen audite të rregullta për të verifikuar zbatimin e politikës SHSSM.

Reagimi në raste urgjente

- Ne kemi sisteme të instaluar dhe personel të trajnuar për t'u përgjigjur në raste urgjente gjatë veprimtarive tona. Nëse ndodh një aksident, rutina jonë e përgatitjes për aksidente dhe burimet në këtë kuadër do të përgjigjen për të kufizuar pasojat dhe për të rikthyer veprimtarinë në gjendje të sigurt.

Luca Schieppati (Managing Director)

Baar, 15th November 2017
Revision 4

Walter Peeraer (President)